

A jemi të detyruar që gjatë nënshkrimit të marrëveshjes parapaguese të paraqesim fotokopje të formularëve M1 dhe M2?

- Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes parapaguese disa operator të telekomunikimit, në pajtim me politikën e tyre punuese, mund të kërkojnë nga abonentët të dorëzojnë dhe vërtetim pune. Nuk përjashtohet mundësia në vend të vërtetimit të punës të kërkohen formularët M1 dhe M2, por vetëm më pëlqim të veçantë nga të dy palët, për shkak se këto formular përmbajnë të dhëna personale, siç janë përkatësia etnike, niveli arsimor dhe të njëjtat llogariten si dokumente të tepërta për nënshkrimin e marrëveshjes parapaguese.

Çka nëse paraqitet ndonjë problem apo paqartësi ?

Për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale mund të kontaktoni administratorin për mbrojtjen e të dhënave personale pranë operatorit të telekomunikimit.

Derisa ekziston dyshimi se të dhënat tona personale janë keqpërdorur në çfarëdo lloj mënyre, Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale është institucioni i vetëm për të kontrolluar dyshimet.

Deri të Drejtoria mund të dërgohet iniciativë për inspektimin e dyshimit ose kërkesë për shkeljen apo cenimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Drejtoria për ruajtjen e dhënave personale

Rr. "Samoilova" nr. 10
1000 Shkup
(02)3230 635

www.dzlp.mk
info@dzlp.mk

Facebook: Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale

Agjencia për komunikim elektronik

Për çështjet lidhur me marrëveshjen parapaguese të rregulluara me Ligjin për komunikim elektronik ankesa mund të dorëzohet deri të Agjencia për komunikim elektronik e cila në bazë të kompetencave që ka do ta hulumton rastin konkret

Rr. "Dimitri e Çupovski" nr 13
1000 Shkup
(02)3289 200

www.aek.mk
contact@aek.mk

Facebook: Agjencia për komunikime elektronike

Organizata e konsumatorëve në Maqedoni

Për çdo çështje që konsumatori - shfrytëzues i shërbimeve të telekomunikimit vlerëson se i janë cenuar të drejtat, si konsumator mund t'i drejtohet Organizatës e konsumatorëve të Maqedonisë, e cila përfaqëson interesat e konsumatorëve dhe punon në ngritjen e vetëdijes përmes: informimit, këshillave dhe edukimit, avancimit dhe implementimit të rregullatives ligjore për politikën konsumuese.

Rr. "Vodnjanska" p.p
1000 Shkup
(02)3179 592

www.opm.org.mk
opm@opm.org.mk

NUMRI IM-



**ОТВОРЕНИ
ДЕНОВИ**
заштита на личните
податоци на
потрошувачите



bota ime e MBROJTUR!

Emri dhe mbiemri, adresa, numri amë, dokumenti për identifikim personal janë të dhëna personale të nevojshme për t'i ofruar operatorit të telekomunikimit nëse duam të sigurojmë një të dhënë tjetër personale – numër telefoni!

Gjatë shqyrtimit të ofertave të modeleve tarifore, shërbimeve dhe kushteve, assesi nuk duhet të harrojmë ta shqyrtojmë dhe politikën e privatësisë së operatorëve telefonik. Politika e privatësisë është dokument shumë i rëndësishëm që na e bënë me dije se operatorët e telekomunikimit kujdesen për të dhënat tona personale, gjegjësisht për privatësinë tonë personale.

Çfarë duhet të dimë?!

Për të firmosur një marrëveshje abonimi është e nevojshme operatorit t'i dorëzojmë këto dokumente për të dhënat personale:

- **emri dhe mbiemri.**
- **adresa**
- **numri amë ,**
- **dokument identifikimi**

Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes parapaguese operator i telekomunikimit duhet të na informon për promovimet dhe prodhimet e reja /shërbimet, mirëpo janë të obliguar të na mundësojnë se pajtohem apo jo për kryerjen e drejtpërdrejtë të marketingut. Pajtueshmëria duhet të jetë ndaras nga kushtet dhe detyrimet nga dispozitat tjera të parapara në marrëveshjen parapaguese.

Pasi të kemi firmosur kontratën e abonimit me një nga operatorët telefonik , ai nga ne duhet të merr pëlqimin tonë se pajtohem apo nuk pajtohem që numri i telefonit tonë të publikohet në regjistrin e përgjithshëm telefonik.

Cilat janë të drejtat dhe detyrimet tona për të mbrojtur të dhëna personale?

E para, të informohemi – për çfarë qëllimi operatori i telekomunikimit i kërkon dhe i përpunon të dhënat tona personale.

Të drejtën për të pasur qasje gjatë përpunimit të dhënave personale nga operatori i telekomunikimit.

Të drejtën për të kërkuar përmirësimin dhe fshirjen e të dhënave personale të cilat gabimisht janë shënuar ose të dhënave të cilave u ka skaduar afati i ruajtjes.

E drejta për të rënë dakord apo jo për prezantimin e marketingut të drejtpërdrejtë ose numri ynë i telefoni të bëhet publik në regjistrin e përgjithshëm telefonik.

Detyrimi për të përdorur dokumente të vlefshme dhe dhënien informata të sakta të dhënave gjatë nënshkrimit të marrëveshjes parapaguese.

Detyrohemi në kohë dhe saktë ta informojmë operatorin për ndryshimin e të dhënave personale.

Detyrimi për të mos keqpërdorur të dhënat personale të personave tjerë, përdorimin e dokumenteve të falsifikuara për identifikim personal ose përdorimin e dokumenteve të identifikimit pa dijeninë e personin të cilit i takojnë.

Cilat janë detyrimet e operatorëve të telekomunikimit?

- Të përpunojnë të dhënat tona në pajtim me ligjin.
- Të dhënat personale që i grumbullojnë të jenë adekuate, relevante dhe jo të tepruara sa i përket qëllimit, për çka dhe kërkojnë të dhënat personale që i ruajnë dhe i përpunojnë për ne të jenë të sakta dhe vazhdimisht të azhurnohen.
- Të dhënat personale të mos ruhen më gjatë se sa koha e parapara për plotësimin e kushteve për çka dhe ishin marrë të dhënat personale.

- Të sigurojnë masa teknike dhe organizative për të siguruar fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave tona personale.

Shpesh pyesim:

Operatori i telekomunikimit, sa ka të drejtë të mbajë fotokopjen e letërnjoftimit apo pasaportës?

- Operatori i telekomunikimit detyrohet të kërkojë dokument për identifikim, por jo edhe për të ruajtur dhe mbajtur fotokopjen e saj. Fotokopja e dokumentit për identifikim personal konsiderohet si përpunim i tepruar, ndërsa fotokopja mund të mbahet vetëm në bazë të një marrëveshjeje të veçantë.

Sa kohë pas skadimit të marrëveshjes parapaguese operator i telekomunikimit mund të ruan të dhënat tona?

- Në pajtim me dispozitat ligjore ekzistuese, periudha e ruajtjes së të dhënave personale është një vit nga data e lëshimit të faturës së fundit për shërbimet e ofruara nëse parapaguesi nuk ka borxh të hapur. Ruajtja e të dhënave pas këtij afati është jo ligjore dhe nuk është në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Mbajtja e të dhënave pas këtij afati nuk është në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa ka të drejtë operator i telekomunikimit t'ju dërgon SMS porosi dhe e-mail për promovime apo prodhime të reja?

- Po, vetëm nëse ne kemi dhënë pëlqim për këtë. Pëlqimi për marketing të drejtpërdrejtë duhet të jetë i ndarë dhe operator detyrohet të na mundësojë tërheqjen e këtij pëlqimi në çdo kohë.